



# **BISHZ - VAIS - UIAS**

**BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR**  
**VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ**  
**UNION DES INTELLECTUELS ALBANAIS EN SUISSE**  
**UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA**

Bahnstrasse 92 - 3008 Bern

## **Rregullorja e punës së kryesisë së BISHZ-së**

### **BISHZ - VAIS - UIAS**

**15.11.2003 - 31.12.2005**

**Versioni 2.0**

Id. i dokumentit	E:\BISHZ\SEKRETARIATI\RREGULLORJA-2004.DOC
Klasifikimi:	Vetëm për shfrytëzim të brendëshëm
Versioni:	2.0
Krijuesi:	Ahmet Xhigoli
Data e krijimit:	12.12.2003
Firma:	Bashkimi i intelektualëve shqiptarë në Zvicër (BISHZ)
Është shtypur më:	12.12.2003
Përgatitja e fundit:	12.12.2003
Emri i fajllës:	RREGULLORJA-2004.DOC
U shpërndahet:	Anëtarëve të kryesisë / Udhëheqësve-Zëvendësudhëheqësve të seksioneve dhe Administratorëve të BISHZ-së
Data e shpërndarjes:	<b>13.12.2003</b>

# Përmbajtja

Faqe

1.	Lidhur me këtë dokument	3
1.1.	<i>Qëllimi dhe dokumentet përcjellëse</i>	3
1.2.	<i>Shkurëtesat</i>	3
1.3.	<i>Azhurimi i dokumentit</i>	4
1.4.	<i>Kontrolla dhe lëshimi në përdorim</i>	4
1.5.	<i>Krijimi dhe kontrolla e ndryshimeve</i>	4
2.	Pjesa e përgjithshme	5
2.1.	<i>Emërtimi, përbërja dhe selia</i>	5
3.	Përfaqësimi, paraqitja dhe nënshkrimi në emër të Shoqatës	5
4.	Veprimtaria e Shoqatës	5
4.1.	<i>Ndarja e veprimtarive</i>	5
5.	Kryesia	6
6.	Sekretariati	6
6.1.	<i>Detyrat dhe kompetencat e sekretariatit</i>	6
6.1.1.	<i>Kryetari</i>	6
6.1.2.	<i>Nënkryetari</i>	7
6.1.3.	<i>Sekretari</i>	8
6.1.4.	<i>Arkëtari</i>	8
6.1.5.	<i>Administratori</i>	9
7.	Seksionet	9
7.1.	<i>Udhëheqësi i seksionit</i>	9
7.2.	<i>Zëvendësudhëheqësi i seksionit</i>	10
8.	Anëtarësia	11
9.	Disciplina	11
10.	Anëtar nderi	11
11.	Projektet dhe tribunat	12
11.1.	<i>Organizimi, udhëheqja dhe mbikqyrja</i>	12
11.2.	<i>Ndarja e të ardhurave të realizuara nga projektet, tribunat dhe aktivitetet tjera</i>	12
12.	Sekreti afarist dhe shërbyes	12
13.	Publikimi i punës së Shoqatës	12
14.	Hyrja në fuqi	12

## 1. Lidhur me këtë dokument

Ky dokument paraqet rregullorën e punës së BISHZ-së në periudhën 15.11.2003 deri më 31.12.2005. Ky është një dokument operativ i cili përcakton detyrat për secilin anëtarë të kryesisë së BISHZ-së / Udhëheqës-Zëvendësudhëheqës të seksioneve të BISHZ-së, grupeve dhe komisioneve të caktuara të BISHZ-së, anëtarëve të BISHZ-së dhe njëkohësisht përcjellë zbatimin dhe kryerjen e tyre.

### 1.1. Qëllimi dhe dokumentet përcjellëse

Ky dokument vlenë për kryesinë e BISHZ-së.

Dokumenti bazohet në:

- Statutin e BISHZ-së
- Programin e punës të BISHZ-së
- Qëllimet e BISHZ-së për vitin 2004
- Paraqitjen e BISHZ-së

### 1.2. Shkurëtesat

BISHZ	Bashkimi i intelektualëve shqiptarë në Zvicër	
VAIS	Vereinigung der albanischen Intellektuellen in der Schweiz	
UIAS	Union des intellectuels albanais en Suisse	
UIAS	Unione intellettuali albanesi in Svizzera	
KRYE	Kryesia e BISHZ-s	2000 ( shënimi shifror )
SEK	Sekretariati i BISHZ-së	2100 ( " )
SHËN	Seksioni për shëndëtesë	2200 ( " )
TEK	Seksioni për teknikë	2300 ( " )
JUR	Seksioni për çështje juridike	2400 ( " )
EKO	Seksioni për ekonomi	2500 ( " )
SOC	Seksioni për çështje sociale	2600 ( " )
DPO	Seksioni për diplomaci-politikë	2700 ( " )
INF	Seksioni për informim	2800 ( " )
KUL	Seksioni për kulturë	2900 ( " )
SPO	Seksioni për sport	3000 ( " )
AR	Seksioni për arsimit	3100 ( " )
PËRK	Seksioni për përkthime	3200 ( " )
VP	Veprimtaria botuese	3300 ( " )
KST	Komisioni statutar	
KKR	Komisioni i kontroll-revizionit	
AK	Anëtarë i kryesisë	
US	Udhëheqës i seksionit	
ZUS	Zëvendësudhëheqës i seksionit	
ADM	Administrator	
UP	Udhëheqës i projektit	
BPP	Bashkëpunëtor i projektit	
ANN	Anëtar Nderi	
AN	Anëtar	

### 1.3. Azhurimi i dokumentit

Ky dokument mund të zgjerohet me kërkesën e kryesisë së BISHZ-së. Ky është poashtu bazë për krijimin e versioneve të reja.

Dokumenti është i përgatitur në formë të decentralizuar në shërbyesin e BISHZ-së.

### 1.4. Kontrolla dhe lëshimi në përdorim

Detyra	Emri	Data	Nënshkrimi / Leja
Kontrollë	Ahmet Xhigoli	15.11.2003	
Lëshimi në përdorim	Ahmet Xhigoli	15.11.2003	

### 1.5. Krijimi dhe kontrolla e ndryshimeve

Versioni	Data	Autori	Vërejtje
1.0	25.10.1998	Ahmet Xhigoli	Rregullorja e punës së BISHZ-së në periudhën 30.11.1997 - 30.11.1999
2.0	15.11.2003	Ahmet Xhigoli	Rregullorja e punës së BISHZ-së në periudhën 15.11.2003 - 31.12.2005

## **2. Pjesa e përgjithshme**

### **2.1. Emërtimi, përbërja dhe selia**

#### *Neni 1*

Kryesia është organ udhëheqës i BISHZ-së, i zgjedhur në Kuvendin e rregullt dhe ka mandatin për dy vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. Mban emërtimin Kryesia e BISHZ-së me seli në Bernë.

Kryesia e ka selinë në lokalet e BISHZ-së, në Bahnstrase 92, CH-3008 Bern.

## **3. Përfaqësimi, paraqitja dhe nënshkrimi në emër të Shoqatës**

#### *Neni 2*

Kryesues dhe udhëheqës i Shoqatës është kryetari.

Paraqitjen dhe përfaqësimin e Shoqatës para organeve, institucioneve dhe personaliteteve e bëjnë kryetari, nënkryetari, sekretari dhe arkëtari e në rast nevojë edhe anëtarët tjerë të Kryesisë, me autorizim nga kryetari.

#### *Neni 3*

Kryetari së bashku me nënkryetarin, sekretarin dhe arkëtarin udhëheq Shoqatën dhe ndërmerr të gjitha detyrat juridike në emër dhe në llogari të Shoqatës, në kuadër të kompetencave të dhëna me këtë rregullore, në bazë të statutit dhe akteve tjera të përgjithshme të Shoqatës.

#### *Neni 4*

Kryetarin në mungesë e zëvendëson nënkryetari ose sekretari ose ndonjë këshilltar të cilin ai e autorizon. Kryetari me autorizim të plotë mund t'ia bartë kompetencat e përfaqësimit të Shoqatës në komunikim juridik personit tjetër. Përbajtjen edhe masën e autorizimit e cakton kryetari në përputhje me normat e statutit.

## **4. Veprimtaria e Shoqatës**

#### *Neni 5*

Veprimtaria e Shoqatës është: bashkimi i potencialit intelektual shqiptar në Zvicër dhe vënia e tij në shërbim të çështjes kombëtare në përgjithësi dhe të komunitetit shqiptar në Zvicër; zhvillimi i projekteve profesionale e shkencore; organizimi i veprimtarive kulturore dhe tribunave të ndryshme; zhvillimi i dokumentacionit teknik, analiza; mbikqyrje gjat projektimit dhe kryerjeve të detyrave; dhënie të konsultimeve profesionale dhe shkencore; recenzimi dhe revizioni i projekteve, punimeve profesionale dhe shkencore; botimet, veprimtaria informatike.

### **4.1. Ndarja e veprimtarive**

#### *Neni 6*

BISHZ ka në përbërje të vet ka një numër të konsiderueshëm të kuadrove profesionale nga lëmi të ndryshme. Veprimtaria e tij është e ndarë në 12 seksione:

- Seksioni për shëndetësi
- Seksioni për teknikë
- Seksioni për çështje juridike
- Seksioni për ekonomi
- Seksioni për çështje sociale-integrim
- Seksioni për diplomaci-politikë
- Seksioni për informim
- Seksioni për kulturë
- Seksioni për sport
- Seksioni për arsim
- Seksioni për përkthime
- Seksioni për veprimtari botuese

Seksionet janë njësi organizative të BISHZ-së në të cilat qartësohen aktivitetet profesionale të fushave të caktuara. Në kuadër të BISHZ-së seksionet marrin pjesë në organizimin e veprimtarve profesionale, zhvillim dhe bashkëpunim profesional me ekonomi dhe personat tjerë juridik, posaçërisht nga fusha e veprimtarisë së tyre.

## **6. Kryesia**

### *Neni 7*

Kryesinë e BISHZ-së e përbëjnë: Kryetari, Nënkryetari, Sekretari, Arkëtari dhe të paktën pesë këshilltarë të Kryesisë (udhëheqës të seksioneve).

Kryesia ka për detyrë ta organizojë e ta udhëheqë aktivitetin e BISHZ-së, si dhe ta kordinojë punën e seksioneve.

## **7. Sekretariati**

### *Neni 8*

Në sekretariat bëjnë pjesë kryetari, nënkryetari, sekretari dhe arkëtari.

Sekretariatit në punë i ndihmojnë tre administrator.

### *Neni 9*

Sekretariati së bashku me këshilltarët e Kryesisë ka për detyrë ta organizojë e ta udhëheqë aktivitetin e BISHZ-së, si dhe ta kordinojë punën e seksioneve.

### *Neni 10*

Për shkak të kryerjes së detyrave të përgjithshme administrativo-teknike dhe të kontabilitetit të BISHZ-së sekretariati përfshinë këto shërbime:

- shërbimi i përgjithshëm
- shërbimi i kontabilitetit
- biblioteka
- shërbimi për mirëmbajtje

## **7.1. Detyrat dhe kompetencat e sekretariatit**

### *Neni 11*

Sekretariati në emër të Kryesisë, udhëheq dhe organizon veprimtarinë e BISHZ-së. Ai konsulton këshilltarët (anëtarët e Kryesisë) lidhur me aktivitetin e seksioneve përkatëse si dhe lidhur me vendimet që duhet marrë, veçanërisht atëherë kur vendoset për çështje të rëndësishme të BISHZ-së.

Në bazë të këtij neni Sekretariati posaçërisht:

- vendos për ndrrimin e statutit të BISHZ-së me propozim të kryesisë së BISHZ-së.
- vendos për rreshtimin e vendeve të këshilltarëve të BISHZ-së me propozim të kryesisë së BISHZ-së.
- rreshton punën dhe afarizmin e Shoqatës.
- emëron dhe shkarkon anëtarët e kryesisë / udhëheqësve-zëvendësudhëheqësve, anëtarët e komisioneve të cilëve i'u është besuar detyra.
- në bashkëpunim me kryesinë propozon zhvillimin dhe politikën afariste të BISHZ-së, si dhe masat e kryerjes së tyre.
- kujdeset për sigurimin e mjeteve për veprimtari dhe zhvillim të Shoqatës.
- bjen vendim për shfrytëzimin e mjeteve të BISHZ-së në kufijtë e caktuar në përputhje me Statut dhe këtë Rregullore.
- bjen vendim për lidhjen e mardhënies dhe shkëputjes së punës në mes të BISHZ-së dhe anëtarëve të saj, në përputhje me Statut dhe këtë rregullore.
- i'a paraqet raportin vjetor kryesisë së BISHZ-së dhe e informon për punën dhe afarizmin e Shoqatës dhe i'a paraqet mëtej Kuvendit të Shoqatës në përputhje me Statut dhe këtë rregullore.

Sekretariati për punën e tij i pëgjigjet Kryesisë dhe Kuvendit të BISHZ-së në përputhje me Statut dhe këtë rregullore.

### **7.1.1. Kryetari**

#### *Neni 12*

Detyrat dhe kompetencat e kryetarit janë zbatimi i nenit 10 dhe neneve tjera të përshkruara me këtë Rregullore.

#### *Neni 13*

Zgjedhja e kryetarit bëhet me propozim të Kuvendit në bazë të nenit 7.c. të Statutit të BISHZ-së

Kryetari për punën e tij i pëgjigjet Kryesisë dhe Kuvendit të BISHZ-së në përputhje me Statut dhe këtë rregullore.

#### *Neni 14*

Kryetari mund të shkarkohet nga detyra e tij edhe para përfundimit të mandatit të tij.

Kuvendi i BISHZ-së do të shkarkon kryetarin:

- nëse me vetë dëshirë kërkon shkarkim
- nëse detyrën e vet nuk e kryen në përputhje me Statut dhe këtë rregullore.

Propozimin me arsytim për shkarkim të kryetarit e ndërmerr kryesia dhe i'a paraqet Kuvendit të BISHZ-së

#### *Neni 15*

Nëse vendi i kryetarit mbetet i lirë para përfundimit të afatit të zgjedhjes, zgjedhja e kryetarit të ri do të bëhet në afat prej 30 ditë në bazë të nenit 7.c. të Statutit të BISHZ-së, pasi që vendi është zbratur.

Kryesia e BISHZ-së do të emëron kryesin e detyrës deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

#### *Neni 16*

Kryetari i ri merr të gjitha detyrat menjëherë pas zgjedhjes së tij.

### **7.1.2. Nënkyetari**

#### *Neni 17*

Kryetari i ndihmon nënkryetari në përcjelljen e veprimtarive të seksioneve të BISHZ-së. Në kuadër të saj përcjell rrjedhat brenda dhe jashtë BISHZ-së .

#### *Neni 18*

Nënkyetari zgjedhet në afat prej dy viteve.

Për nënkryetar mund të zgjedhet cilido anëtarë-këshilltar nga radhët e kryesisë së zgjedhur nga Kuvendi i shoqatës.

Nënkyetari, për punën e tij i përgjigjet sekretariatit, kryesisë dhe Kuvendit të BISHZ-së.

#### *Neni 19*

Nënkyetari mund të shkarkohet nga detyra e tij edhe para përfundimit të mandatit të tij.

Kryesia e BISHZ-së do të shkarkon nënkryetarin:

- nëse me vetë dëshirë kërkon shkarkim
- nëse detyrën e vet nuk e kryen në përputhje me Statut dhe këtë rregullore.

Propozimin me arsytim për shkarkim të nënkryetarit e ndërmerr Sekretariati dhe Kryesia dhe i'a paraqet Kuvendit të BISHZ-së.

#### *Neni 20*

Nëse vendi i nënkryetarit mbetet i lirë para përfundimit të afatit të zgjedhjes, zgjedhja e nënkryetarit të ri do të bëhet në afat prej 30 ditë pasi që vendi është zbratur.

Kryesia e BISHZ-së do të emëron kryesin e detyrës deri në zgjedhjen e nënkryetarit të ri.

#### *Neni 21*

Nënkyetari i ri merr të gjitha detyrat menjëherë pas zgjedhjes së tij.

### **7.1.3. Sekretari**

#### *Neni 22*

Sekretari i BISHZ-së:

- jep mendime profesionale dhe juridike si dhe shpjegime lidhur me zbatimin e statutit dhe rregullorës dhe rregullave tjera të përshkruara nga sekretariati dhe kryesia e BISHZ-së
- mbanë protokolet e mbledhjeve të kryesisë së BISHZ-së dhe formon propozimet e akteve të përgjithshme të kryesisë së BISHZ-së
- drejtëpërsëdrejti kujdeset dhe është përgjegjës për kryerjen e detyrave organizative, administrative, juridike dhe punëve tjera të përgjithshme të BISHZ-së.

#### *Neni 23*

Sekretari zgjedhet në afat prej dy viteve.

Për sekretar mund të zgjedhet cilido anëtarë-këshilltar nga radhët e kryesisë së zgjedhur nga Kuvendi i Shoqatës.

Sekretari, për punën e tij i përgjigjet sekretariatit, kryesisë dhe Kuvendit të BISHZ-së.

Sekretari mund të shkarkohet nga detyra e tij edhe para përfundimit të mandatit të tij.

Kryesia e BISHZ-së do të shkarkon sekretarin:

- nëse me vetë dëshirë kërkon shkarkim
- nëse detyrën e vetë nuk e kryen korrekt gjegjësisht në përputhje me Statut dhe këtë rregullore.

Propozimin me arsyetim për shkarkim të sekretarit e ndërmerr Sekretariati dhe Kryesia dhe i'a paraqet Kuvendit të BISHZ-së.

#### *Neni 24*

Nëse vendi i sekretarit mbetet i lirë para përfundimit të afatit të zgjedhjes, zgjedhja e sekretarit të ri do të bëhet në afat prej 30 ditë pasi që vendi është zbratur.

Kryesia e BISHZ-së do të emëron kryesin e detyrës deri në zgjedhjen e sekretarit të ri.

#### *Neni 25*

Sekretari i ri merr të gjitha detyrat menjëherë pas zgjedhjes së tij.

### **7.1.4. Arkëtari**

#### *Neni 26*

Arkëtari kryen detyrat financiare të parapara me Statut dhe me rregullorën e punës së BISHZ-së.

Arkëtari:

- jep sekretariatit dhe kryesisë së BISHZ-së mendime profesionale dhe financiare-juridike si dhe shpjegime lidhur me direktivat e zbatimit të ligjit dhe rregullave administrative në udhëheqjen dhe administrimin e punëve financiare dhe materiale të BISHZ-së.
- kontrollon rregullësinë e finacave dhe kontabilitetit dhe përcjell hyrjen - daljen financiaro-materiale të BISHZ-së
- përcjell ardhjen e mjeteve dhe gjendjen e fondeve të BISHZ-së dhe për këtë e njofton kryetarin.

#### *Neni 27*

Arkëtari zgjedhet në afat prej dy viteve.

Për arkëtar mund të zgjedhet cilido anëtarë-këshilltar nga radhët e kryesisë së zgjedhur nga Kuvendi i Shoqatës.

Arkëtari, për punën e tij i përgjigjet sekretariatit, Kryesisë dhe Kuvendit të BISHZ-së.



#### *Neni 28*

Arkëtari mund të shkarkohet nga detyra e tij edhe para përfundimit të mandatit të tij.

Kryesia e BISHZ-së do të shkarkon arkëtarin:

- nëse me vetë dëshirë kërkon shkarkim
- nëse detyrën e vet nuk e kryen në përputhje me Statut dhe këtë rregullore.

Propozimin me arsyetim për shkarkim të arkëtarit e ndërmerr Sekretariati dhe Kryesia dhe i'a paraqet Kuvendit të së BISHZ-së.

#### *Neni 29*

Nëse vendi i arkëtarit mbetet i lirë para përfundimit të afatit të zgjedhjes, zgjedhja e arkëtarit të ri do të bëhet në afat prej 30 ditë pasi që vendi është zbratur.

Kryesia e BISHZ-së do të emëron kryesin e detyrës deri në zgjedhjen e arkëtarit të ri.

#### *Neni 30*

Arkëtari i ri merr të gjitha detyrat menjëherë pas zgjedhjes së tij.

### **7.1.5. Administratori**

#### *Neni 31*

Sekretariati, për kryerjen e punëve të përgjithshme administrativo-teknike dhe të kontabilitetit të BISHZ-së angazhon tre administratorë.

Administratorët posaqërisht:

- kujdesen për shfrytëzimin efikas të infrastrukturës së BISHZ-së
- kujdesen për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe gjendjen e materialit hargjues të nevojshëm për veprimtarin e BISHZ-së
- kujdesen për kryerjen e punëve korrente të shërbimeve të përgjithshme, si dhe për detyrat tjera të cilat dalin nga veprimtaria e sekretariatit.
- drejtëpërsëdrejti kujdesen dhe janë përgjegjës për bibliotekë dhe për mirëmbajtjen e lokalit.

#### *Neni 32*

Administratori zgjedhet në periudhë prej dy vjetëve. I njejt person mund të zgjedhet për administrator dy herë njëpas një.

Për administrator mund të zgjedhet cilido anëtarë nga radhët e BISHZ-së të propozuar nga Sekretariati.

Administratori, për punën e tij i përgjigjet Sekretariatit dhe Kryesisë së BISHZ-së.

#### *Neni 33*

Administratori mund të shkarkohet nga detyra e tij edhe para përfundimit të mandatit të tij.

Kryesia e BISHZ-së do të shkarkon Administratorin:

- nëse me dëshirë të vetë kërkon shkarkim.
- nëse detyrën e vet nuk e kryen si duhet, në pajtim me këtë Rregullore dhe aktet e përgjithshme të Shoqatës gjegjësisht sipas udhëzimeve dhe direktivave të Sekretariatit.

Propozimin me arsyetim për shkarkim të administratorit e ndërmerr Sekretariati dhe i'a paraqet Kryesisë së BISHZ-së

#### *Neni 34*

Nëse vendi i administratorit mbetet i lirë para përfundimit të afatit të zgjedhjes, zgjedhja e administratorit të ri do të bëhet në afat prej 30 ditë pasi që vendi është liru.

## **8. Seksionet**

### **8.1. Udhëhqësi i seksionit**

#### *Neni 35*

Udhëhqësi i seksionit udhëheq punën me seksion dhe e rreshton veprimtarinë e tij.

Udhëhqësi i seksionit posaqërisht:

- udhëheq mbikqyrjen e projekteve të seksionit të tij dhe kujdeset për rregullësinë e kryerjes së tyre në përputhje me programin e punës së Shoqatës;
- cakton planin kërkimor dhe punën profesionale në seksion;
- kujdeset për shfrytëzimin optimal të infrastrukturës së BISHZ-së;
- kujdeset për veprimtarin e seksionit në kuadër të mjeteve financiare disponuese;
- thëret mbledhjet e anëtarëve të seksionit dhe i njofton ata për rrjedhat e rëndësishme lidhur me interesat e seksionit dhe Shoqatës në përgjithësi;
- kujdeset për disiplinën e punës në seksion;
- kujdeset për kryerjen e punëve korrente në përpuethshmëri me vendimet e kryesisë së BISHZ-së, sekretariatit dhe aktet e përgjithshme të brendëshme, si dhe kryen edhe detyrat tjera të cilat dalin nga veprimtaria e seksionit.

Për udhëhqës të seksionit mund të zgjedhet cilido anëtarë-këshilltar nga radhët e kryesisë së zgjedhur nga Kuvendi i Shoqatës.

Për punën e tij, udhëhqësi i seksionit i përgjegjet sekretariatit dhe kryesisë së BISHZ-së.

#### *Neni 36*

Udhëhqësin e seksionit e zgjedh kryesia e BISHZ-së në propozim nga seksioni.

Udhëhqësi i seksionit zgjedhet në periudhë prej dy vjetëve.

#### *Neni 37*

Udhëhqësi i seksionit mund të shkarkohet nga detyra para përfundimit të mandatit në të cilin është zgjedhur.

Kryesia e BISHZ-së do të shkarkon udhëhqësin e seksionit:

- nëse me dëshirë të vetë kërkon shkarkim.
- nëse detyrën e vet nuk e kryen si duhet, në pajtim me këtë Rregullore dhe aktet e përgjithshme të Shoqatës gjegjësisht sipas udhëzimeve dhe direktivave të Sekretariatit.

Propozimin me arsyetim për shkarkim të udhëhqësit të seksionit e ndërmerr Sekretariati dhe Kryesia dhe i'a paraqet Kuvendit të BISHZ-së.

#### *Neni 38*

Udhëhqësin e seksionit gjatë mungesë së tij e zëvendëson zëvendësudhëhqësi i tij ose anëtari i seksionit të cilin ai vet e cakton.

#### *Neni 39*

Nëse vendi i udhëhqësit të seksionit mbetet i lirë para ose pas afatit të zgjedhjes, zgjedhja e udhëhësit të ri në mënyrë sipas së cilës është caktuar me këtë rregullore në afat prej 30 ditëve pasi që vendi është liruar.

Kryesia e BISHZ-së me propozim të sekretariatit e emëron kryesinë e detyrës së udhëhqësit të seksionit nga radhët e anëtarësisë së seksionit deri në zgjedhjen e udhëhqësit të ri.

#### *Neni 40*

Udhëhqësi i ri i seksionit merr të gjitha detyrat menjëherë pas zgjedhjes së tij.

## **8.2. Zëvendësudhëheqësi i seksionit**

### *Neni 41*

Udhëhësit të seksionit në punë i ndihmon zëvendësudhëheqësi i tij.

Për zëvendësudhëheqës të seksionit mund të zgjedhet cilido anëtarë-këshilltarë nga radhët e kryesisë së zgjedhur nga Kuvendi i Shoqatës ose nga radhët e anëtarësisë së seksionit. Zëvendësudhëheqësi i seksionit zgjedhet në afat prej dy viteve.

### *Neni 42*

Udhëheqësit të seksionit i ndihmon zëvendësudhëheqësi në përcjelljen e veprimtarisë së seksionit. Mbanë protokolet e mbledhjeve të seksionit dhe formon propozimet e akteve të përgjithshme të seksionit .

Për punën e tij, udhëheqësi i seksionit i përgjegjet sekretariatit dhe kryesisë së BISHZ-së.

### *Neni 43*

Zëvendësudhëheqësi mund të shkarkohet nga detyra e tij edhe para përfundimit të mandatit të tij në të cilin është zgjedhur.

Kryesia e BISHZ-së do të shkarkon zëvendësudhëheqësin:

- nëse me vetë dëshirë kërkon shkarkim
- nëse detyrën e vet nuk e kryen korrekt, gjegjësisht në përputhje me Statut dhe këtë rregullore.

Propozimin me arsytim për shkarkim të zëvendësudhëheqësit e ndërmerr sekretariati dhe kryesia dhe i'a paraqet Kuvendit të BISHZ-së

### *Neni 44*

Nëse vendi i zëvendësudhëheqësit mbetet i lirë para përfundimit të zgjedhjes kohore, zgjedhja e zëvendësudhëheqësit të ri do të bëhet në afat prej 30 ditë pasi që vendi është zbrazur.

Kryesia e BISHZ-së do të emëron kryesin e detyrës deri në zgjedhjen e zëvendësudhëheqësit të ri.

### *Neni 45*

Zëvendësudhëheqësi i ri merr të gjitha detyrat menjëherë pas zgjedhjes së tij.

## **9. Anëtarësia**

### *Neni 46*

Anëtarët e kryesisë i zgjedh Kuvendi i rregullt zgjedhor (që mbahet një herë në dy vjet). Në periudhën në mes të dy Kuvendeve, kryesia mund të bëjë plotësime dhe zëvendësime të nevojshme, të cilat marrin formë të prerë vetëm pasi të miratohen nga Kuvendi.

Shkarkimin nga detyra e anëtarit të kryesisë e bën Kuvendi, në këto raste:

- në rast të mosrizgjedhjes
- me kërkesën personale të anëtarit
- pas suspendimit me vendim të Kryesisë. (Kur shkel rregullat e BISHZ të përcaktuara me statut, program të punës dhe rregullore, apo kur me qëndrimet e tij anëtari paraqet pengesë për mbarëvajtjen e punës së BISHZ-së).

## **10. Disiplina**

### *Neni 47*

Nga të gjithë anëtarët e Kryesisë së BISHZ kërkohet disiplinë dhe përpikëri në kryerjen e detyrave. Pjesëmarrja në mbledhjet e Kryesisë është e obligueshme. Pas tri mungesave të paarësyeshme, sekretariati kërkon sqarim nga anëtari dhe, varësisht nga rrjedha e bisedës, mund të marrë masën e suspendimit.

## **11. Anëtar nderi**

### *Neni 48*

Anëtar nderi i BISHZ-së është thirrje nderi të cilën Shoqata i'a ndan anëtarëve të merituar të BISHZ-së të cilët posaçërisht kanë merita për zhvillim dhe përparim të BISHZ-së.

Thirrjen e merituar anëtar nderi të BISHZ-së i'a ndan kryesia e BISHZ-së me propozim të kryetarit.

## **12. Projektet dhe tribunat**

### **12.1. Organizimi, udhëheqja dhe mbikqyrja**

#### *Neni 49*

Kryesia e BISHZ organizon, udhëheq dhe mbikqyrë realizimin e projekteve profesionale e shkencore, tribunave dhe aktiviteteve tjera të parapara me këtë rregullore.

#### *Neni 50*

Projektet që propozohen nga seksionet shqyrtohen nga ekspertët përkatës të asaj lëmie dhe miratohen ose refuzohen nga sekretariati (në raste të veçanta këshillohet kryesia).

Projektet që burojnë nga sekretariati gjithashtu shqyrtohen nga ekspertët përkatës dhe nga i njejt kontaktohet seksioni përkatës dhe realizuesit e projektit.

#### *Neni 51*

Realizuesi apo grupi realizues i projektit të ofruar, caktohet nga kryetari në bashkëpunim me sekretariatit e BISHZ-së.

Administrimi i projektit bëhet nga udhëheqësi i projektit nën mbikqyrje të kryetarit dhe sekretariatit.

#### *Neni 52*

Kryetari së bashku me nënkryetarin, sekretarin dhe arkëtarin janë nënshkrues të të gjitha akteve juridike për projekte, tribuna dhe aktivitete tjera të parapara me këtë rregullore.

Kryetari jep udhëzime anëtarëve të sekretariatit për përpilim të dokumenteve përkatëse, në përputhje me rregullorën e punës, për secilin projekt, tribunë apo aktivitet tjetër të ofruar nga pala e jashtme ose nga sekretariati ose nga seksionet e BISHZ-së dhe ndërmer masat për realizim konkret.

Pala e jashtme ose pala nga ana e BISHZ-së të cilat i ofrojnë punë BISHZ-së, kontaktojnë drejtëpërsëdrejti me kryetarin, në mungesë të tij me nënkryetarin ose me sekretarin e BISHZ-së.

#### *Neni 53*

Emërimin e udhëheqësit / grupit punues për realizim të projektit e bën kryetari gjegjësisht sekretariati në bashkëpunim me udhëheqësit e seksioneve.

Udhëheqësi i projektit për punën e tij i përgjigjet kryetarit dhe sekretariatit.

#### *Neni 54*

Udhëheqësi ose anëtari i grupit punues për realizim të projektit mund të shkarkohet nga detyra e tij edhe para përfundimit të realizimit të projektit.

Kryetari i BISHZ-së do të shkarkon udhëheqësin ose anëtarin e grupit punues për realizim të projektit:

- nëse detyrat e formuluar në projekt nuk i kryen në kohë të caktuar
- nëse nuk u përgjigjet kërkesave të formuluar në kontratë të nënshkruar në mes të BISHZ-së dhe palës së jashtme (klientit).
- nëse nuk e informon me kohë kryetarin dhe sekretariatit për problemet e shkaktuara

Udhëheqësi ose anëtari i shkarkuar me propozim të kryetarit dhe sekretariatit do të plotësohet me udhëheqës ose anëtar të ri të emëruar sipas nenet 46.

## **12.2. Ndarja e të ardhurave të realizuara nga projektet, tribunat dhe aktivitetet tjera**

*Neni 55*

Të ardhurat bruto që realizohen nga një projekt, në emër të BISHZ-së, ndahen në raport; 60% për BISHZ dhe 40% për realizuesit e projektit.

BISHZ nga 60 % përmbush të gjitha detyrimet që burojnë nga Ligji zviceran i Detyrimeve dhe ai i punës për punëdhënësit (kontributet sociale etj.).

Realizuesit e projektit përmbushin të gjitha detyrimet ndaj pjesëmarrësve në realizim (pagesa e mëditjeve, honorareve etj.)

## **13. Sekretet afarist dhe shërbyes**

*Neni 56*

Sekret afarist dhe shërbyes konsiderohen të dhënat, dokumentet, aktet e përgjithshme dhe shënimet tjera të deklaruara sekrete, të mbështetura në ligj dhe aktet e përgjithshme të Shoqatës.

Me rregullore të posaçme më detalisht zërthehen paragrafet e shërbimit sekret të punës.

## **14. Publikimi i punës së Shoqatës**

*Neni 57*

Shoqata informon publikisht rreth kryerjes së veprimtarive ose veprave të veprimtarive përmes raportit vjetor.

Vetëm kryetari ose personi të cilin ai e autorizon mund përmes gazetave, radios dhe televisionit të informon publikun për veprimtarinë e BISHZ-së.

## **15. Hyrja në fuqi**

*Neni 58*

Kjo rregullore e punës, bëhet e plotfuqishme menjëherë pas miratimit nga Kryesia e BISHZ-së dhe vlenë aq sa zgjat mandati i Kryesisë që e ka miratuar atë.

Bernë, 13 nëntor 2003

Numër: 01-20031113/1

Kryetari

Dr. sc. Ahmet Xhigoli